

Elhamiu dhe Destani ishin komshinjtë e parë. Në mbrëmjen e datës 18.07.1998, Elhamiu dhe Destani, si dhe miku i tyre Ramadan Durguti, e nisën për ta çuar imamin e plagosur, Shani Sylkaj, në spitalin e UÇK-së në Gajrak [Malishevë/Mališevo]. Shkuan me makinën e Destanit, të tipit *BMW*. Në kthim nga spitali, një orë pas mesnate [19.07.1998], në hyrje të **Rahoveci/Orahovac**, në afërsi të pikës së karburanteve *Agrofer*, hasën në policinë serbe, e cila pa asnjë paralajmërim hapi zjarr drejt tyre. Elhamiun e vranë në vend, përderisa Destani, edhe pse i plagosur, vazhdoi ta ngiste makinën. Pas afro 300-400 metrash, e ndali makinën dhe ai dhe Ramadani ikën në drejtime të kundërta. Ishte kjo hera e fundit kur Ramadani e shihte Destanin të gjallë. Pas përfundimit të luftës, në muajin korrik të vitit 1999, kufoma e Destanit u gjet në varrezat e Prizrenit/Prizren. Në datën 18.07.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Destanit në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac. Trupi i Elhamiut akoma nuk është zbuluar. Zhdukja e tij nuk u paraqit nga familjarët te KNKK.

Burimet: deklarata V.M, FDH-879; deklarata R.D, FDH-12940; deklarata S.T, FDH-15506; KKKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Osman (Xhemail) Osa

(25.06.1965, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, mjeshtër, katër fëmijë)

Osmani ka qenë mjeshtër për mirëmbajtjen e pajisjeve teknike për kuzhinë. Pas hyrjes së forcave serbe në Rahovec/Orahovac, në orët e hershme të mëngjesit [19.07.1998], Osmani me familje kanë kaluar te i vëllai Selimi. Nga aty, u nisën për ta braktisur qytetin. Hipën në makinën e Selimit, por Osmani u kthye që ta merrte vëllain e tretë Enverin dhe bashkëshorten e tij Shqipen, e cila ishte shtatzënë dhe para lindjes. Kur, më në fund, të gjithë u nisën që ta braktisnin qytetin, në rrugë e sipër e vërejtën zjarrin që e kishte kapluar fabrikën e Selimit për prodhimin e plastikës. Osmani i tha Enverit që të ndalte makinën dhe doli për ta shuar zjarrin, ndërkaq familjarët e tij e vazhduan rrugën. Ishte kjo hera e

fundit kur ata e shihnin Osmanin të gjallë. Në datën 1.08.1998, mbetjet mortore të Osmanit u zbuluan në ahurin e djegur të Ymerit, përballë fabrikës së Selimit [**Rahovec/Orahovac**]. Familjarët e kanë identifikuar Osmanin falë dokumenteve të identifikimit dhe çelësave. Policia serbe e ka kryer hetimin në vendngjarje paradite, përderisa mbetjet mortore të Osmanit u varrosën pas dite në varrezat myslimane, ku prehet edhe sot.

Burimet: deklarata N.N, FDH-873; deklarata H.S, FDH-20097; deklarata P.O, FDH-33500; KKKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00614, FDH-35527.

Sylejman (Sefer) Sharku

(6.07.1955, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, kuvar, katër fëmijë)

Zeqir (Jonuz) Hoxha

(2.02.1958, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, tregtar, tre fëmijë)

Eshref (Haxhi) Shehu

(23.05.1960, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, tre fëmijë)

Murat (Sahit) Deliu

(6.07.1963, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, tregtar, tre fëmijë)

Xhelal (Sadedin) Ejupi

(2.01.1974, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, punëtor)

Ramadan (Sadik) Krçagu

(9.04.1957, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, punëtor, katër fëmijë)

Shiqajdin (Sadik) Krçagu

(11.07.1968, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, punëtor, dy fëmijë)

Sylejmani, Murati, Eshrefi, vëllezërit Ramadani dhe Shiqajdini, si dhe Xhelali jetonin me familjet e veta në afërsi të vreshtave, të vendi i quajtur Bllato. Zeqiri kishte punuar në Sarajevë, por u kthye në Rahovec/Orahovac disa vjet para luftës. Ishte drejtor i hotelit *Park*. Më pas, më vëllain e hapi shitoren tregtare *Hoxha*.

Ditën e diel, më 19.07.1998, rreth orës 5:00, banorët e lagjes *Krstić* me qëllim largimin nga qyteti, e formuan kolonën,